

VENDIM
Nr. 437, datë 3.6.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2020, në programin buxhetor “Arsimi bazë” 09120, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për pagesën e TVSH-së së dhurimit të pajisjeve tablet nga fondacioni “Vodafone *Albania*”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama